




Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT NËNTOR

Nëntor, 2023



PËRMBAJTJA

1	METODOLOGJIA	3
2	TË GJETURAT KRYESORE	5
3	SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE	6
4	SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE	8

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT NËNTOR DHE ÇRREGULLIMET E INFORMACIONIT

1 Koha e monitorimit

1-30 nëntor 2023.

2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube, TikTok dhe Instagram.

3 Mostra

Në gjuhën shqipe dhe serbe.

4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i çrregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit nëntor në Kosovë.

Ky raport është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbulueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje i përhapjes së lajmeve me çrregullim të informacionit. Instituti D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformata, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm. Kategoritë të cilat kanë mbizotëruar gjatë muajit nëntor në mostrën e gjuhës shqipe kanë qenë: zhvillimet në veri, ndasitë, polarizimi politik dhe gjuha e urrejtjes. Ndërsa, në mostrën në gjuhën serbe ka pasur artikuj me përmbajtje të çrregullimit të informacionit në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi dhe zhvillimet në veri. Në të dy mostrat mbizotërojnë narrativa të paverifikuara pas sulmit në Banjskë, më 24 shtator.


Prej secilës mostër janë verifikuar 1000 artikuj me lexueshmërinë më të madhe. Në mostrën në gjuhën shqipe nga 1000 artikuj, 215 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit, kurse në mostrën në gjuhën serbe nga 1000 artikuj të analizuar, 249 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

3. TË GJETURAT KRYESORE

- Gjuhë nxitëse- gjatë monitorimit të lajmeve në mostrën në gjuhën shqipe janë vërejtur tituj me gjuhë fyese dhe nxitëse ndaj figurave publike, duke përdorur tituj të ekzagjërues me terma ofendues. Instituti D4D kanë analizuar mënyrën e raportimit që nxisin ragimin e lexuesit/ndjekësit e mediave dhe portaleve. Raportimet e njëanshme dhe me gjuhë ofenduese nxisin qytetarët që të përforcojnë gjuhën e urrejtjes ndaj figurave publike.
- Propagandë dhe informata të paverifikuara - në mostrën në gjuhën serbe vazhdojnë narrativat e rrejshme kundër figurave politike në Kosovë, të cilat barten nga persona zyrtarë të sferës politike në Serbi si dhe nga mediat. Sa i përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi, mediat serbe vendosin Kryeministrin Albin Kurtin, si problemin kryesor të tensioneve ndërmjet dy shteteve.
- Kërcënimet online - Instituti D4D gjatë periudhës së monitorimit në nëntor ka vërejtur rritje të kërcënimeve online për gazetarët hulumtues. Një rast i tillë ka qenë për gazetarin nga emisioni televiziv hulumtues në Klan Kosova “Kiks Kosova” i cili është kërcënuar duke kryer punën e tij.
- Teoritë konspirative- Gjate muajit nëntor shumë artikuj kanë si përmbajtje supozimet se një sulm i dytë nga Serbia është i mundur. Supozimet në fjalë lënë hapsirë për lexuesit të nxisin pasiguri, dhe ndodhë që të përhapen informata të paverifikuara, të cilat janë të pabazuara.

4. SHEMBUJ NË GJUHËN SHQIPE

Muaji nëntor në ambientin mediatik fillon me kërcënime ndaj mediave dhe gazetarëve të cilët hulumtojnë mashtrimet e bërë nga njerëz për përfitime personale, e ku palë e dëmtuar janë qytetarët të cilët bien pre e këtyre mashtrimeve.



Kësisoj, emisioni Kiks Kosova, gazetari i të cilit u kërcënua me jetë nga një person shaku i një hulumtimi të bërë për pirateri të IPTV-së. Mesazhe me përmbajtje kërcënuese si “Haver, mos mbyllunse sakt ta kam adresen pot tregoj mbyllunsehe kos dil. Vec pot kallxoj dhe mos munperzjij se nuk han gazetari H. Ademi i ka thënë se nuk shkak të kërcënimeve, personi dojnë , Fol me kon dush pot perzjij ne pun te mija qe din me dit qikaq di met than pik“ kërcënimeve, rasti është bërë Asociacioni i Gazetarëve të reguar në mbrojtje të gazetarit H.



Rasti në fjalë tregon se sa është kërcënuese e cila po rrezikon dhe pengon gazetarët gjatë punës së tyre. Është mos hezitimi nga ana e kërcënuesit, edhe pse veprime të tilla janë të penalizueshme.

Lajmi është shpërndarë në rreth 45 medime dhe është një shembull i mirë i unifikimit të mediave ndaj problemit të gjuhës së urrejtjes me numër në total 629,056.4 trafikun e klikueshmërisë në faqet online.

Lajme

I dënuari për keqpërdorim seksual me të miturën thotë se Adem Jashari ka lindur me 10 tetor e jo 28 nëntor

November 29, 2023

1 minute



Portali Epilogu ka publikuar një tjetër artikull me titull: 'I dënuari për keqpërdorim seksual me të miturën thotë se Adem Jashari ka lindur me 10 tetor e jo 28 nëntor.' Titulli në fjalë shkruan për Gazmend Halilaj, i cili pretendon se ditëlindja e ish komandatit të UÇK-së, Adem Jashari, është gënjeshtër. Në vend të emrit Gazmend Halilaj, artikulli vendos **"I dënuari për keqpërdorim seksual me të miturën"**, duke zëvendësuar emrin me një veti negative të personit në fjalë. Njejt si në rastin paraprak, edhe në artikullin në fjalë cilësohet si raportim i njëanshëm duke e shfaqur personin Gazmend Halilaj, si një person negativ për të rritur klikueshmërinë dhe për të nxitur lexuesit kundër personit në fjalë.

Artikulli është shpërnadrë edhe në Facebook, ku ka grumbullar 13 pëlqime dhe 4 komente, ndërsa i njejt lajm në dy faqet online të publikuar ka grumbulluar rreth 826 lexues/klikime.

Narrativa që vazhdon të jetë prezente në media që nga rasti i Banjskës, është edhe ajo në lidhje me një sulm të mundshëm nga ana e Serbisë.

Portali InfoKosova ka publikuar një artikull me titull: Kastrati: **Serbia përmes paramilitarëve do të synojë ndonjë masakër në veri**". 6.9 mijë klikime në faqe online gjatë muajit nëntor

Bota Sot gjithashu publikon artikujt: **"Ibishi: Me shpërthimet në veri, Serbia synon ta mbaj situatën të tensionuar"** 322.9 mijë klikime në faqen online gjatë muajit nëntor

Që nga sulmi në Banjskë në shtator të vitit 2023, vazhdimisht njohës dhe konspiracionistë të politikës janë intervistuar dhe kanë paralajmëruar se do të ketë sulme të tjera nga ana e Serbisë. Parashikimet në fjalë sjellin pasiguri dhe frikë te qytetarët, me qëllim që të ketë ndërveprime dhe klikueshmëri të lartë.

BOTA SOT

BALLINA LAJME BOTA KOSOVA SHQIPËRIA MAqedonia SPORTI SHO

AKTUALE

Ibishi: Me shpërthimet në veri, Serbia synon ta mbaj situatën të tensionuar

ME: 27 NENTOR 2023 NE ORA: 23:58



Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie



16 Janar, 2024

Comissions Policy Code of Ethics Ownership & Funding Info Accuracy Introduction Data Us

infokosova.

BALLINA LAJME SPORT VIP SHËNËTA TECH KURIOZITË

Kastrati: Serbia përmes paramilitarëve do të synojë ndonjë masakër në veri

Etikete nga infokosova

27 Nëntor, 2023



6. SHEMBUJ NË GJUHËN SERBE

Dy nga titujt më poshtë janë të marra nga portali serb Informer.ks, të cilat pasqyrojnë sferën mediatike në serbi dhe mënyrën se si raportohet për Kosovën.



Për ekstremistët e shiptarë, vetëm një serb i vdekur është serb i mirë! Banditët e Kurtit u hodhën sërish në veri të K.M! Artikulli ka grumbulluar 116 ndërveprime, prej tyre 6 pëlqime dhe 110 shpërndarje.

12 muaj krizë dhe mizoria më e tmerrshme! Një vit më parë serbët thoshin “mjaft më”, dhe u ngrit terrori edhe më i tmerrshëm i Albin Kurtit. Artikulli ka 93 ndërveprime, prej tyre 93 shpërndarje.

Për lexuesit serb, qeveria e Kosovës portretizohet si një regjim që “terrorizon” komunitetin serb. Gjetje të ngjashme janë evidentuar edhe në muajt paraprak. Përmes këtyre titujve po krijohet një “e vërtetë” tjetër për qytetarët në Serbi, gjë që krijon më shumë ndasi etnike dhe nxitë më shumë urrejte, nga të cilat kërcënohet edhe stabiliteti në vend dhe rajon.



Kurir publikon artikullin me titull **‘KURTI PROMOVON KRIJIMIN NAZIST! Ideja e një “Shqipërie të madhe” vazhdon të jetojë në kokat e EKSTREMISTËVE – njofton lista serbe.’** Titulli në fjalë është mjaft shqetësues pasi që qeveria e Kosovës krahasohet me ideologjinë naziste. Njejtë si në dy rastet e para, lexuesit e këtyre mediave krijojnë një realitet të gabuar për Kosovën përmes titujve me çrregullim të informacionit dhe me lajme të rrejshme.

Për më tepër, tituj të tillë nxisin tensione dhe urrejtje ndër etnike. Artikulli ka grumbulluar 55 ndërveprime, prej tyre 55 shpërndarje. Faqja online e mediumit Informer.rs, për muajin nëntor ka pasur 1.5 milion klikime, ndërsa Kurir në faqen online, gjatë muajit nëntor ka grumbulluar 12.1 milion klikime.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **www.d4d-ks.org**

Mbështetur nga:

